



KOMUNA ISTOG

THIRRJE PUBLIKE PËR ANËTARËSIM NË ASAMBLENË E KËSHILLIT LOKAL RINOR

Në bazë të nenit 19 të Ligjit Nr. 08/L-264, Komuna Istog e shpall thirrjen publike për aplikim për anëtarësim në Asamblenë e Këshillit Lokal Rinor të Komunës së Istogut

Asambleja e Këshillit Lokal Rinor të Komunës së Istogut është Asamble e organizatave rinore, organizatave për të rinjtë, këshillave të nxënësve të shkollave të mesme të larta dhe forumeve rinore të partive politike e cila ka për detyrë themelimin e Këshillit Lokal Rinor të Komunës së Istogut, aprovimin e aktit të themelimit të tij.

Drejtoria Komunale e rinisë së Komunës së Istogut ka për detyrë mbledhjen e aplikimeve dhe formimin e komisionit i cili ka përgjegjësi të bëjë kontrollimin e aplikimeve sipas dokumenteve të listuara në këtë thirrje publike.

Të gjitha organizatat rinore, organizatat për të rinjtë, këshillat e nxënësve të shkollave të mesme të larta dhe forumet rinore të partive politike që e përmbushin kriteret e nenit 23 të Rregullores (MKRS) Nr. 09/2024 për Procedurat e Themelimit, Funksionimin dhe Punën e Këshillave Rinor bëhen pjesë e asamblesë së Këshillit Lokal.

Të gjithë të interesuarit duhet të dërgojnë dokumentet si më poshtë:

1. **Letra motivuese** e cila specifikon përvojën, qëllimet e strukturës aplikuese për të qenë pjesë e Asamblesë dhe të dhënat bazike të përfaqësuesit të moshës rinore të deleguar;
2. **Portfolio** e strukturës aplikuese;
3. **Certifikata e regjistrimit** (për OJQ-të) **apo njohja zyrtare** nga shkolla apo partia politike (për këshillat e nxënësve dhe forumet rinore të partive politike);
4. **CV** e përfaqësuesit/es të deleguar nga struktura aplikuese për të qenë anëtar/e i/e Asamblesë;
5. **Certifikata e gjendjes penale** të përfaqësuesit/es.

Afati për aplikim dhe dorëzim të aplikacioneve dhe dokumentacionit sipas Rregullores së MKRS nr. 09/2024, dorëzohen në email-en: drin.sadikaj@rks-gov.net nga data 24.06.2026 deri me datë 15.07.2026, në ora 16:00.



Drejtoreshë: Era Rexhaj

Rexhaj